

Nr. regj. 2963/2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Gëzim(Ibrahim)Baxhaku, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 5 par 1 pika 1.3 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 31.07.2012 morri këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI: Gëzim(Ibrahim)Baxhaku**, i lindur më 30.08.1952 në fshatin Bellobrad Komuna Dragash, tani me vendbanim në Rrugën "Haxhi Zeka, nr. 4/2", në Prishtinë, këshilltarë politik për media, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse gjatë kontrollit të plotë është konstatuar se në deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31mars në Agjencinë kundër korrupsion, nuk e ka deklaruar pasurinë për anëtarët e familjes dhe atë për vajzën Azra Baxhaku, e që ka qenë i obliguar ta deklaroj sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, -me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5 par 1 pika 1.3 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

## **D Ë N I M**

**Me gjobë në shumë prej 300(treqind)€**, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **20(njëzet) ditësh**, duke e llogaritur për çdo **15 €**, nga **1(një) ditë burgu**. Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **5 €**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë**, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën nr. 01-362/2012 më datë 27.01.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen nga neni 4 par 1 dhe 3 duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit. Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se pasi që është emëruar si Këshilltar Politik për media në Ministrinë e Integritimit Evropian më datë 12.04.2010 në mënyrë të rregullt çdo herë ka deklaruar pasurinë, poashtu dhe për vitin 2011, ka bërë deklarimin e rregullt vjetor mirëpo në bisedë e sipër me disa persona i kanë thënë pasi që vajzat janë të martuara dhe kanë pasuri të veçantë nuk ka nevojë të deklaron pasurinë për ato ndërsa për shkak të angazhimeve të shumta vetë nuk e ka lexuar ligjin, prandaj ka menduar se nuk ka nevojë ta deklaron pasurinë për ato, arsyeja e mosdeklarimit ka qenë vetëm një informimi i gabuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari ftoi Agron Behramin, përfaqësues i Agjencisë kundër Korrupsion, i cili deklaroi se i pandehuri ngarkohet për kundërvajtjen nga neni 5 par 1 pika 1.3 e jo nga neni 4 par 1 dhe 3 të ligjit në fjalë, pasi që Gëzim Baxhaku e ka deklaruar pasurinë dhe gjatë kontrollimit paraprak nuk kanë vrejtë që ka ndonjë mangësi në deklaram, mirëpo më vonë gjatë kontrollit të plotë është konstatuar se i njëjti ka një vajzë dhe atë Azra Baxhaku, të cilin nuk e ka paraqit si fëmijë dhe se nuk e ka deklaruar pasurin të cilën e posedon Azra si anëtare e familjes së tij.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin të deklaratës së të pandehurit, vlerësimin të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen neni 5 par 1 pika 1.3 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.5 e cila i vihet në barrë pasi që nuk e ka deklaruar pasurinë e vajzës së vetë Azra Baxhaku, ndërsa sipas ligjit është i obliguar ta deklaron pasurinë për anëtarët e familjes ku bënë pjesë dhe fëmijët e duke pas parasysh se Azra Baxhaku është fëmijë-vajza e tij e cila posedon pasuri, andaj e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, duke pas parasysh se e ka bërë deklaramin e rregullt vjetor, por vetëm nuk e ka deklaruar pasurinë e vajzës Azra Baxhakut, duke menduar që pasi është e martuar vajza dhe ka pasuri të veçantë nuk ka nevojë ta deklaron, gjyqtaria konsideroi se nuk i është shmangur deklaramin të pasurisë së vajzës, por për shkak të mosnjohjes së ligjit mirëpo mosnjohja e ligjit nuk e liron nga përgjegjësia dhe pasi që më vonë e ka deklaruar pasurinë edhe për fëmijët të tjerë, i shqiptoj gjobën me bindje se edhe me këtë dënim me gjobë në shumë prej 300 €, do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
**Nr. Regj. 2963/2012, më datë 31.07.2012**

Gjyqtaria  
Azra Cakolli

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimin të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.